



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

### VENDIM

#### PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR GROPOSJEN E KAFSHËVE ME SËMUNDJE INFEKTIVE NË FSHATIN BËRNICË E EPËRME NË PRISHTINË

1. Miratohet caktimi i lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërnice e Epërme, në Prishtinë.
2. Lokacioni nga pika 1 e këtij vendimi, gjendet në kuadër të Planit zhvillimor komunal, i miratuar me Vendimin e KK së Prishtinës, 01. nr. 035-181427, i dt. 24.09.2013 (*parcela e propozuar sipas Planit zhvillimor komunal, shtrihet në zonë të destinuar për gjelbërim*), parcela kadastrale, nr. 00081-0 ZK Bërnice e Epërme ka sipërfaqe kadastrale prej 21 arë, ku pronësia e parcelës nr. 00081-0 ZK Bërnice e Epërme, është pronë e "PSH, Komuna e Prishtinës".
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi dhe ekstrakti nga PZHU.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, dhe Drejtoria e Kadastrit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-353/01-183723/23, më 05.09.2023

KRYESUES I KUVENDIT  
Pëllumb Bajcinda



## ARSYETIM

### I Vendimit për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërnice e Epërme, në Prishtinë

Në bazë të kërkesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, është kërkuar nga Komuna e Prishtinës që të identifikojë dhe caktojë një lokacion për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive. Komuna e Prishtinës në bazë të takimeve të zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të AUV-së dhe Komunës së Prishtinës, është arritur pajtimi për caktimin e lokacionit në fshatin Bërnice e Epërme, në Prishtinë.

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartëcekur, ka identifikuar lokacionin për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive. Kjo parcelë gjendet në kuadër të Planit zhvillimor Urban, të miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 nr. 035-181427, dt. 24.9.2013 (parcela e propozuar sipas Planit zhvillimor komunal, shtrihet në zonë të destinuar për gjelbërim), parcela kadastrale nr. 00081-0, ZK Bërnice e Epërme (ka sipërfaqe kadastrale prej 21 arë). pronësia e parcelës nr. 00081-0, ZK Bërnice e Epërme, është pronë komunal, "PSH, Komuna e Prishtinës".

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se në këtë parcelë nuk ka ndërtime, terreni kryesisht është i rrafshët ndërsa qasja në parcelë është përmes rrugës "Smajl Hajdaraj", parcela në fjalë nga vendbanimi më i afërt ka distancë ajrore prej 700m.

Duke pasur parasysh që Plani Zhvillimor Urban aktual nuk i ka të përcaktuara lokacionet e kësaj natyre dhe duke pasur parasysh urgjencën e kërkesës nga institucioni vartës, gjatë procesit të hartimit të Planit zhvillimor komunal dhe Hartës zonale, Komuna këtë parcelë do ta harmonizojë me dokumentet e planifikimit të cilat janë proces të hartimit.

#### Informata tjera:

1. Nr. i parcelës: 00081-0,
2. Zona Kadastrale: Bërnice e Epërme
3. Sipërfaqja: 2,100m<sup>2</sup>
4. Koordinatat hapësinore: 42.726545, 21.173671

#### **Bashkëngjitur:**

- skica e lokacionit të propozuar,
- ekstrakti nga Plani zhvillimor urban.

- Lokacioni i propozuar



- Pjesa grafike nga Plani Zhvillimor Urban;

